



2022/27

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01- Nr- 100-36392

Më datë 20.06.2022

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016” e konform nenit 30, dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Lejohen mjete financiare në vlerë prej 4.000,00€ avancë për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës në Suharekë z. Bexhet Kuçi me rastin e shkuarjes në vizitë zyrtare në Sarandë të Shqipëri, mjetet financiare lëshohen nga zyra e Kuvendit të Komunës së Suharekës.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Arsyetim

Me rastin e shkuarjes në vizitë zyrtare me ftesën e Bashkisë së Sarandës të Republikës së Shqipërisë, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Suharekës me anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës, u vendos të lejohet avancë në vlerë financiare prej 4.000,00€ në emer të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës z. Bexhet Kuçi-t, mjetet financiare lëshohen nga zyra e Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Të njoftohen,
DEF
Evidenca

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

